



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1050/1 prot.

Tiranë më 8.6.2023

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2944/3 prot., datë 02.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1050 prot., datë 05.06.2023, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për miratimin në parim të konventës “Mbi marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatojmë se, kjo Konventë zbatohet për marrëveshjet ekskluzive, për zgjedhjen e gjykatës, të cilat janë lidhur në çështjet civile ose tregtare, dhe nuk lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me fushën e veprimtimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me Projektvendimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi